

Si të falemi!

6

Falënderimi i takon vetëm All-llahut, paqja dhe bekimi i All-llahut qofshin mbi robin dhe të Dërguarin e Tij Muhammedin, mbi familjen, mbi shokët e tij dhe mbi ata që e ndjekin atë deri në Ditën e Gjykimit.

Shtylla e dytë prej shtyllave të Islamit është falja e namazit. Namazi u bë obligim në natën e Miraxhit, kur i Dërguari i All-llahut^S u ngrit lart në qiell, gjë që ndodhi tri vite para se të emigronte për në Medine. Në fillim namazi u bë obligim vetëm dy rekate, ndërsa kur i Dërguari i All-llahut emigroi për në Medine, u shtua numri i rekateve. Kështu namazi i drekës u bë katër rekate, i ikindisë katër rekate, i jacisë katër rekate, i sabahut dy rekate dhe i akshamit tre rekate.

Është detyrë për çdo musliman ta dijë se namazi është prej shtyllave më madhështore pas dy dëshmimeve. Kush e ruan atë (namazin), ka ruajtur fenë e tij. All-llahu i Madhëruar thotë: «*Ruani kohët e namazit (faljes) si edhe atë të mesmen dhe para All-llahut qëndroni me përlujt!*» [El Bekare, 238].

Transmetohet se njëri nga sahabët ka thënë: “I Dërguari i All-llahut^S u pyet: “*Cila është puna më e mirë?*”, dhe tha: “*Namazi në kohën e tij, respektimi i prindërve dhe xihadi (lufta në rrugën e All-llahut).*”

Namazi është lidhja mes All-llahut dhe robit të Tij. I Gjithmëshirshmi përcaktoi për robërit e Tij pesë kohë namazi, shpërblimi për to do të jetë sa për pesëdhjetë namaze. Namazi është gjëja e parë për të cilin All-llahu i Madhëruar do t’i pyesë robërit e Tij në Ditën e Gjykimit.

Namazi është dritë në varrin e errët, ku njeriu në të nuk shikon dritën e diellit dhe as dritën e hënës. I Dërguari i All-llahut^S ka thënë: «*Namazi është dritë.*» Pra, dritë në zemër. Nëse ndriçohet zemra, ndriçohet edhe fytyra. Gjithashtu namazi është dritë dhe në Ditën e Tubimit. All-llahu i Madhëruar thotë:

«*...dritën që do të shohësh besimtarët dhe besimtare, me dritën e tyre që shkëlqen para dhe në të djathtë të tyre (e do t’u thuhet): “Lajm i mirë sot për ju: kopshtet e Xhenetit nëpër të cilat rrjedhin lumenjtë e ku do të banoni përgjithmonë. Kjo është fitorja më e madhe!*» [El Hadid, 12]

Porosia e fundit me të cilën Profeti^S e porositi umetin e tij ishte namazi. Është transmetuar nga Ummu Selemeh^Q se ka thënë: “Profeti^S në sëmundjen e rëndë për shkak të së cilës ndërroi jetë, thoshte: «*Kujdesuni për namazin dhe çfarë keni nën posedim!* » Këto fjalë përsëriste derisa ia dorëzoi shpirtin All-llahut të Madhëruar.

ABDESI:

1. Bëhet nijetin me zemër.
2. Thuhet Bismillah.
3. Lahen duart tri herë.
4. Shpërlahet goja dhe hunda tri herë.
5. Lahet fytyra tri herë.
6. Lahen duart deri në bërryla tri herë, duke filluar nga dora e djathtë.
7. Fërkohet e gjithë koka me duar të lagura (mes’ h), pastaj dhe veshët.
8. Lahen këmbët deri në nyje tri herë, duke filluar nga këmba e djathtë.

GJËRAT QË PRISHIN ABDESI:

1. Çdo gjë që del nga dy vendet e jashtëqitjes.
2. Dalja e diçkaje të ndyrë prej trupit.
3. Largimi i vetëdijes, duke rënë në gjumë apo me diçka tjetër.
4. Prekja e organit gjenital pa pasur ndonjë pengesë mes dorës dhe organit.
5. Ngrënia e mishit të devesë.
6. Largimi nga Islami (All-llahu na mbrojtë ne dhe të gjithë muslimanët nga kjo!).

KUSHTET E NAMAZIT:

1. Islami (të jetë musliman/e)
2. Të arrijë të logjikojë.
3. Mosha e pjekurisë.
4. Pastrimi nga papastërtitë si nevoja, marrdhëniet
5. Largimi i pisllëkut konkret si urina apo e vjella.
6. Mbulimi i pjesëve të turpshme.
7. Hyrja e kohës së namazit.
8. Drejtimi nga Kibla(Qabja).
9. Nijeti (qëllimi).

EZANI:

1. All-llahu ekber (4)
2. Eshhedu en la ilahe il-lallah (2)
3. Eshhedu enne muhammeden resulullah(2)
4. Hajjales-salah (2)
5. Hajjalel-felah (2)
6. All-llahu ekber (2)
7. La ilahe il-lallah (1)

IKAMETI:

1. All-llahu ekber (2)
2. Eshhedu en la ilahe il-lallah (1)
3. Eshhedu enne muhammeden resulullah(1)
4. Hajjales-salah (1)
5. Hajjalel-felah (1)
6. Kad kametis-salah (2)
7. All-llahu ekber (2)
8. La ilahe il-lallah (1)

GJËRAT QË PRISHIN NAMAZIN:

1. Çdo fjalë që thuhet qëllimisht .
2. Qeshja.
3. Ngrënia.
4. Pirja.
5. Zbulimi i pjesëve të turpshme.
6. Mënjanimi i tepërt nga drejtimi i kiblës.
7. Lëvizja e tepërt dhe e vazhdueshme në namaz.
8. Prishja e abdesit.

REKATET E NAMAZIT:

| | Sunnet | Farz | Sunnet |
|---------|--------|------|--------|
| Sabahu | 2 | 2 | |
| Dreka | 2 + 2 | 4 | 2 |
| Ikindia | | 4 | |
| Akshami | | 3 | 2 |
| Jacia | | 4 | 2 |

NAMAZI I ŠABAHUT



1. Ngrihen duart në drejtim të veshëve ose supeve* duke thënë: “Allahu ekber”.
2. Vendoset dora e djathtë mbi të majtë në gjoks dhe thuhet: *Subhaneke All-llahumme ue bihamdike ue tebareke ismuke ue teala xhedduke ue la ilahe gajruke.* Eudhu bil-lahi mineshejtani raxhim!”



Lexohet surja eFatiha: :

- Bismil-lahi rrahmani rrahim!
 - *Elhamdulil-lahi rabbil alemin*
 - *Er-rahmani rrahim*
 - *Maliki jeumid-din*
 - *Ij-jake na'budu ue ijyake nestein*
 - *Ihdinas-siratal mustekim*
 - *Siratal-ledhine enamte alejhim*
 gajril magdubi alejhim uele ddaaalin.
 (Amin!)

Lexohet një sure tjetër, si: surja Ikhlas: :

- Bismil-lahir-rahmanir-rahim.
 - *Kul hu-uAllahu ehad.*
 - *Allahu ssamed.*
 - *Lem jedid ue lem juled.*
 - *Ue lem jekul-lehu kufiuuen ehad.*

* Gjithashtu i ngrehim duart:
 1. Para dhe pas ngritjes nga rukuja,
 2. Kur ngrihem për rekatin e tretë (pas teshehudit të parë)

3. Përkulemi në ruku duke thënë: “All-llahu ekber”, Në ruku thuhet: “*Subhane rabbijel adhim.*” (3).



4. Ngrihem nga rukuja duke thënë: “*Semi All-llahu limen hamide.*” Pas ngritjes themi: “*Rabbena ue lekel hamd.*”



5. Biem në sexhde duke thënë: “All-llahu ekber”, dhe duke rënë me duar. Në këtë pozitë thuhet: “*Subhane Rabbijel ala.*” (3) .



6. Ngrihem nga sexhdeja duke thënë: “All-llahu ekber” Në këtë pozitë thuhet: “*Rabbi gfirli!*” (2)



7. Biem përsëri në sexhde duke thënë : “All-llahu ekber ” Në këtë pozitë thuhet : “*Subhane Rabbijel ala.*” (3).



8. Thuhet “All-llahu ekber” dhe ngrihem në këmbë për rekatin e dytë.
9. Vendoset dora e djathtë mbi të majtën në gjoks dhe thuhet surja eFatiha dhe një sure tjetër, si: surja Keuther:

- Bismil-lahi rrahmani rrahim!
 - *Inna eëtajnakel keuther.*
 - *Fe sal-li li rabbike uenhar.*
 - *Inne shanieke huel ebter.*

Më pas veprojmë ashtu si në rekatin e parë: përkulemi në ruku, ngrihem nga rukuja, biem në sexhde, qëndrojmë mes dy sexhdeve, biem përsëri në sexhde.

10. Pas sexhdes së dytë themi “All-llahu ekber” dhe ulemi mbi këmbën e majtë, Në këtë pozicion thuhet:

Ettehiatu lil-lahi ues salauatu ue ttajjibatu, esselamu alejke ejuhen nebiju ue rahmetullahi ue berekatuhu, esselamu alejna ue ala ibadil-lahi ssalihin. Eshhedu en la ilahe il-l Allah, ue eshhedu enne Muhammeden abduhu ue resuluhu.

11. *Allahumme sal-li ala Muhammedin ue ala ali Muhammed, kema sal-lejte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim, inneke hamidun mexhid. Allahumme barik ala Muhammedin ue ala ali Muhammed, kema barakte ala Ibrahim ue ala ali Ibrahim, inneke hamidun mexhid.*

12. *Allahumme inni eudhubike min adhabi xhehennem, ue min adhabil kabr, ue min fitnetil mahja uel memmat, ue min fitnetil mesihid- dexhal.*



Në këtë pozitë dora e djathtë vendoset mbi kofshën e djathtë duke e bërë grusht, ndërsa gishti tregues drejtohet nga Qabja duke e lëvizur pak dhe dora e majtë vendoset mbi kofshën e majtë; shikimi hidhet tek gishti tregues.

13. Namazi përfundon duke dhënë selam.

Kthehet koka në anën e djathtë dhe thuhet : “*Esselamu alejkum ue rahmetullah!*” dhe po ashtu edhe në anën e majtë “*Esselamu alejkum ue rahmetullah!*”

NAMAZI I DREKËS, IKINDISË, JACISË

Falen dy rekate njësoj si në namazin e sabahut deri në fund të pikës 10 dhe më pas duke thënë “All-llahu ekber” ngrihem për rekatin e tretë.

Rekati III :

Surja eFatiha, bimë në ruku, ngrihem nga rukuja, bimë në sexhde, qëndrojmë mes dy sexhdeve, bimë përsëri në sexhde dhe ngrihem në këmbë për rekatin e katërt.

Rekati IV :

Surja Fatiha, bimë në ruku, ngrihem nga rukuja, bimë në sexhde, qëndrojmë mes dy sexhdeve bimë përsëri në sexhde, ngrihem nga sexhdja dhe më pas veprojmë si në pikat 10, 11, 12, 13.

NAMAZI I AKSHAMIT

Akshami ka tri rekate. Falen tri rekatet e para njësoj si në tri rekatet e drekës, ndërsa në fund të rekatit të tretë nuk ngrihem, por ulemi dhe veprojmë si në pikat 10, 11, 12, 13.